



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KESHILLI

Nr. 677 prot.

Pogradec, më 20.02 2023

VENDIM

Nr. 19, DATË 17/02/2023

PËR
PËR MIRATIMIN E LISTËS TË SIPËRFAQES SË TOKËS BUJQËSORE DHE
PYJORE PREJ 24,5650 HA, E NDODHUR NË NJËSITË ADMINISTRATIVE
DARDHAS, BUÇIMAS, QË MUND TË JEPEN ME QIRA.

Në mbështetje të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015 "Per Vetëqeverisjen Vendore", neni 2 i ligjit nr. 8312, datë 26.03.1998 "Për tokat bujqësore të pandara", Udhëzimin nr. 1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara" dhe Udhëzimit nr.2, datë 20.04.2016 "Për shfuqëzimin e udhëzimit nr. 3, datë 27.11.2013, të Këshillit të Ministrave "Për pezullimin e përkohshëm të udhëzimit nr.1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara", ligjit 57/220 "Per pyjet", VKM nr 559 date 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave per dhënie në përdorim të fondit pyjor kombëtar, per veprimtari ekonomike, si dhe per prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore" me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë:

VENDOSI:

1. Të miratojë listën e sipërfaqes së tokës bujqësore prej **24,5650** Ha (Njezet e kater presje pesemije e gjashteqind e pesedhjetë ha), të ndodhur në Njësitë Administrative Dardhas, Buçimas që mund të jepen me qera sipas listës.

2.

Nr	Pronësia	Zona Kadastrale	Numëri Pasurisë	Vëndodhja Fshati	Lloji Pasurisë	Sipërfaqja në m2
1	Shtet	3664	292/14	Tushemisht, Buçimas	Pyll	41000
2	Shtet	3664	292/13	Tushemisht, Buçimas	Pyll	4200
3	Shtet	3664	292/12	Tushemisht, Buçimas	Pyll	8350
6	Shtet	3664	292/15	Tushemisht, Buçimas	Pyll	45550
7	Shtet	3529	154	Stropckë Dardhas	Arë	54900
8	Shtet	3529	153	Stropckë, Dardhas	Arë	10200
9	Shtet	3664	142/1	Tushemisht, Buçimas	PF	29100
10	Shtet	3664	141	Tushemisht, Buçimas	PF	29100
Σ	TOTALI					245650

3. Toka Bujqësore që do të jepet me qera do te shfrytëzohet vetëm për veprimtari bujqësore dhe te tjera veprimtari ne funksion te saj, ndersa ato me ze kadastral pyll te zbatohet udhezimi i Ministrise se Mjedisit dhe Turizmit.

4. Afati i dhënies me qera do të jetë në përputhje me destinacionin e kultivimit por asnjëherë më i gjatë se afati i përcaktuar pikën IV të Udhëzimit nr. 1, datë:18.07.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e dhënies me qera të tokave bujqësore të pandara".
5. Çmimi dysHEME i vlerës së qerasë do të jete jo më pak se 6000 (gjashtëmijë) lekë Ha në vit sipas pikës nr 10 të Udhëzimit nr. 1, datë:18.07.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e dhënies me qera të tokave bujqësore të pandara".
6. Çmimi dysHEME i vlerës së qerasë per kategoria pyll sipas Raportit teknik te hartuar nga sektori Pyjor bashkangjitur.
7. Per zbatimin e vendimit ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Burimeve Njerezore dhe Çështjeve Juridike, si dhe Njësitë Administrative Dardhas, Buçimas.
8. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.

KRYETAR I KËSHILLIT

Sotiraq MANGËRI